

VENDIM
Nr.37 datë 25.1.1993

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.23 DATË 9.1.1993 "PËR ORGANIZIMIN E SHËRBIMIT TË PAGESËS SË PAPUNËSISË NGA ADMINISTRATA SHTETËRORE E PUNËS"

Me propozimin e Ministrisë së Punës, të Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.23, datë 9.1.1993, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 ndryshohet si vijon:

"Këshillat e rretheve dhe bashkitë, brenda datës 15.2.1993, t'u sigurojnë zyrave të punës, emigracionit, përkrahjes sociale dhe të përndjekurve politikë mjediset e domosdoshme për kryerjen e shërbimit të pagesës së papunësisë, sipas listës nr.1 që i bashkëngjitet këtij vendimi".

2. Në nenin 5, paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

"Për kryerjen e shërbimit të pagesave në organikën e zyrave të punës, emigracionit, përkrahjes sociale dhe të përndjekurve politikë shtohet një personel prej 162 punonjësish, të ndarë në rrethe e bashki sipas listës nr.2 që i bashkëngjitet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi